



Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/nr. 487/2023
Datë: 26 qershor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj znj. Hava Krasniqi, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 pika 11 dhe nenit 34 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas Raportit të Panelit Hetimor në rastet AD.nr. 06/2023 dhe AD.nr.10/2023, të datës 21 qershor 2023, gjatë shqyrtimit të mbajtur me datë 23 qershor 2022, në seancën e këshillimit e votimit mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Raporti i panelit hetimor AD.nr. 06/2023 dhe AD.nr.10/2023, të datës 21 qershor 2023, në rastin disiplinor të prokurores Hava Krasniqi, Prokuroria Themelore në Prishtinë;**
- II. **Vërtetohet se prokurorja Hava Krasniqi për rastin AD.nr.10/2023, ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 dhe 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;**
- III. **Vërtetohet se tek prokurorja Hava Krasniqi për rastin AD.nr.06/2023, nuk janë gjetur elementet e përgjegjesisë disiplinore në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;**
- IV. **Prokurores Hava Krasniqi për rastin AD.nr.10/2023, i shqiptohet sanksioni disiplinor, "Zvogëlim i përkohshëm i pagës tridhjetë për qind (30%) për një vit" në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.**

A r s y e t i m

Me datë 28 mars 2023, Kryeprokurori në cilësinë e Autoritetit Kompetent në Prishtinë, [REDACTED], pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese me numër [REDACTED], sipas detyrës zyrtare, ka paraqitur kërkesë AD.nr.10/2023, për fillimin e

hetimeve ndaj znj. Hava Krasniqi, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, sepse e njëjta gjatë dhënies se udhëzimeve në kohën përderisa ishte prokurore kujdestare, nuk e ka vlerësuar si duhet rrezikshmërinë e situatës si dhe të kryesit të veprës penale, me ç' rast nuk ka ndërmarrë veprimet procedurale/prokuroriale të cilat veprime është dashur të merren në mënyrë urgjente. Bazuar në kërkesën për inicim të procedurës disiplinore, me datë 03 mars 2021, prokurorja kujdestare Hava Krasniqi kishte pranuar njoftimin nga Stacioni Policor - Graçanicë, se tani e ndjera S.S ishte sulmuar nga ish bashkëshorti L.S, të cilin e kishte liruar në procedurë të rregullt edhe pse i njëjti në vazhdimësi kishte ushtruar dhunë ndaj ish bashkëshortes së tij. Në të njëjtën datë, 28 mars 2023, kryeprokurori në cilësinë e Autoritetit Kompetent në Prishtinë, [REDAKTUAR] ka paraqitur kërkesë AD.nr.06/2023, për fillimin e hetimeve ndaj znj. Hava Krasniqi, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, bazuar në ankesën e palës së dëmtuar [REDAKTUAR] lidhur me trajtimin e rastit të evidentuar me numër Sek. [REDAKTUAR]. Sipas parashtruesit të ankesës pretendohet se me datë 07 shkurt 2023, në shtëpinë e tij është kryer vepra penale vjedhje e rëndë nga neni 315 të KPRK-së, ku janë marr gjësende me vlerë pasurore dhe si veprime operationale që do të duhet të ndërmerreshin nga ana e prokurores Hava Krasniqi, edhe pse nga Policia e Kosovës është paraqitur kërkesa për hyrje dalje dhe hartografi të telekomunikimeve për operatorin e telefonisë mobile, kërkesa është neglizhuar për dy jave nga prokurorja Hava Krasniqi.

Me datë 20 prill 2023, Këshilli Prokurorial i Kosovës, ka themeluar Panelin Hetimor për hetimin e rasteve disiplinore AD.nr.06/2023 dhe AD.nr.10/2023, ndaj znj. Hava Krasniqi, prokurore në Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Paneli Hetimor, në bazë të nenit 13 të Ligjit me nr.06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Neni 14(7), (8) të Rregullores nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve ka propozuar marrëveshje vullnetare për zgjidhjen e kësaj çështje disiplinore, mirëpo pas refuzimit nga ana e subjektit të hetimit, Paneli Hetimor është lëshuar në hetimin e rastit disiplinor.

Me datë 21 qershor 2023, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka pranuar nga Paneli Hetimor, Raportin AD.nr. 06/2023 dhe AD.nr.10/2023, me të cilin, Paneli Hetimor ka ardhur në përfundim se, prokurorja Hava Krasniqi për rastin AD.nr.10/2023, ka vepruar në shkelje të nenit 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 dhe 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve sepse e njëjta gjatë dhënies së udhëzimeve në kohën përderisa ishte prokurore kujdestare, nuk e ka vlerësuar si duhet rrezikshmërinë e situatës si dhe të kryesit të veprës penale edhe pse policia ka marr dëshminë e të dëmtuarës tani të ndjerës S.S, e cila në dëshminë e saj kishte pohuar se ditën kritike derisa ishte në banesën e vajzës së saj, kishte shkuar ish bashkëshorti i saj i cili e kishte goditur me grushta në fytyrë duke shtuar se kjo nuk është hera e parë, që kishte probleme dhe nga koha kur janë divorcuar ka pasur

probleme të vazhdueshme duke i shkaktuar të ndjerës probleme psikologjike. Po ashtu, prokurorja Hava Krasniqi nuk e ka vlerësuar dëshminë e dëshmitares M.S e cila ka deklaruar se ditën kritike përderisa ishte me nënën e saj, kishte ardhur babai dhe e kishte goditur nënën e saj në prezencën e saj, e njëjta ka deklaruar se çdo ditë kanë presion prej babait, e sidomos nëna e saj S.S. Sipas Panelit Hetimor, përkundër këtyre dëshmive relevante për të ndërmarr veprime urgjente për të parandaluar pasojat, subjekti i hetimit disiplinor Hava Krasniqi ka neglizhuar me rastin në fjalë, duke mos e ndaluar të dyshuarin L.S, por duke kërkuar nga policia që të nesërmen të dëgjohet në cilësinë e të dyshuarit L.S dhe pas njoftimit nga policia se është dëgjuar edhe i dyshuari, prokurorja Krasniqi, përsëri nuk ka arritur të vlerësojë rrezikshmërinë e këtij rasti por ka kërkuar që i dyshuari të lirohet në procedurë të rregullt.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 26 qershor 2023, pasi që ka shqyrtuar raportin e dorëzuar nga Paneli Hetimor, ka dëgjuar Raportimin e Kryesuesit të Panelit Hetimor i cili ka elaboruar të gjitha faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës hetimore, duke konstatuar se prokurorja Hava Krasniqi në rastin AD.nr.10/2023, nuk ka ndërmarr veprimet procedurale /prokuroriale të cilat veprime është dashur të merren në mënyrë urgjente përkundër faktit që i dyshuari ka qenë recidivist që ka qenë i dënuar për dhunë në familje dhe ka pasur urdhër mbrojtje.

Për rastin disiplinor AD.nr.06/2023, Paneli Hetimor ka vlerësuar se, me datë 16 shkurt 2023, subjekti i hetimit, prokurorja Hava Krasniqi ka pranuar rastin SEK [REDAKTUAR] të ndërmarr veprime hetimore lidhur me një vjedhje të rëndë, nga neni 315 të KPRK-së, të kryer nga personat të pa identifikuar. Vepra penale kishte ndodhur me 07 shkurt 2023, e që sipas Panelit hetimor, vërtetohet se me datë 14 shkurt 2023, Policia e Kosovës kishte dërguar kërkesën për masa të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit/hyrje-dalje dhe hartografi në Prokurori që do të thotë, pas 7 ditëve nga kryerja e veprës penale, kurse subjekti i hetimit nga momenti kur e ka pranuar kërkesën, ka qenë e angazhuar në seanca për shqyrtime gjyqësore. Me datë 01 mars 2023, ka paraqitur kërkesë tek gjykata kompetente për lëshimin e kësaj mase të fshehtë teknike të vëzhgimit dhe hetimit, i cili rast është ende në procedurë hetimore.

Në seancën disiplinore ka prezantuar edhe subjekti i hetimit disiplinor, prokurorja Hava Krasniqi dhe përfaqësuesi i autorizuar, av. [REDAKTUAR] e cila në mbrojtjen e saj për rastin AD.nr.10/2023, nuk e ka mohuar faktin se për rastin e dhunës në familje të paraqitur nga e ndjera S.S e ka trajtuar në procedurë të rregullt sepse rrezikshmërinë e përcakton policia në aspektin teknik në teren. Mungesa e deklaratave shtesë të të dëmtuarës dhe ankueses vajzës së tyre, refuzimi për vazhdimin e urdhrin mbrojtës dhe në aspektin që një i mitur ju ka besuar babait kanë ndikuar për të vlerësuar që për momentin rasti të shkon në procedurë të rregullt. Prokurorja Hava Krasniqi ka deklaruar se ditën kritike nuk ka pasur njohuri që i dyshuari ka qenë recidivist, e ka

ditur që kanë qenë të shkurorëzuar por nuk ka parë asnjë vendim që ka pasur për dhunë në familje sepse nuk ka pasur qasje në sistemin SMIL.

Për rastin disiplinor AD.nr.06/2023, subjekti i hetimit prokurorja Hava Krasniqi në mbrojtjen e saj deklaroi se, kërkesa fillimisht nuk ka qenë urgjente dhe veprimi është ndërmarr, potencialisht kohëzgjatja e ndërmarrjes së veprimit ka qenë për pamundësi objektive duke pasur parasysh ngarkesën në punë, përfaqësimet dhe orarin e kujdestarisë. Vjedhja ka ndodhur me 07 shkurt 2023, ndërsa me datën 16 shkurt 2023 ka fundi i orarit e ka pranuar kërkesën. Të nesërmen ka qenë festë 17 shkurt, mandej e shtunë e diel dhe nga data 20 shkurt deri me 24 shkurt ka pasur përfaqësimet në Lipjan, pastaj 4 ditë kujdestari. Lënda është ende tek unë, masat enden nuk kanë përparim edhe pse janë duke u aplikuar.

Këshilli Prokurorial i Kosovës pas dëgjimit të Kryesuesit të Panelit Hetimor, Subjektit të Hetimit si dhe shqyrtimit, analizimit, krahasimit të provave të cekura në raportin e panelit hetimor, fjalës përfundimtare të Kryesuesit të Panelit Hetimor dhe prokurores Hava Krasniqi, erdhi në përfundim se, në rastin AD.nr.10/2023, është vërtetuar shkelja disiplinore si në dispozitiv të këtij vendimi. Prokurorja Hava Krasniqi ka dështuar në ushtrimin e profesionit të prokurorit sepse, mungesa e vlerësimit të rrezikut nga ana e prokurores Krasniqi pas raportimit të dhunës në familje, duke marr për bazë faktin që i dyshuari L.S ishte recidivist, kishte dënim për vepër penale në vitin 2019, kishte urdhër mbrojtje të lëshuar nga Gjykata dhe dy deklarata për ushtrimin e dhunës ndaj viktimës tani të ndjerës S.S. Prokurorja Hava Krasniqi ka neglizhuar me rastin duke mos ndërmarr veprime hetimore nga data e raportimit të dhunës, përkatësisht 03 mars 2021 deri në vrasjen e të ndjerës, 14 mars 2021. Periudha prej 10 ditësh që kur prokurorja Krasniqi ishte në fazën e grumbullimit të provave dhe informatave të nevojshme është dashur të ishte në dijeni që kishte rrezik real për të ndjerën S.S, prandaj me dështimin e ndërmarrjes së masave në kohë ka dështuar në mbrojtjen e jetës së të ndjerës S.S.

Ndërsa për rastin AD.nr.06/2023, Këshilli Prokurorial i Kosovës pas dëgjimit të Kryesuesit të Panelit Hetimor, Subjektit të Hetimit si dhe shqyrtimit, analizimit, krahasimit të provave të cekura në raportin e panelit hetimor, fjalës përfundimtare të Kryesuesit të Panelit Hetimor dhe prokurores Hava Krasniqi, me shumicë votash erdhi në përfundim se, në rastin AD.nr.06/2023, nuk është vërtetuar shkelja disiplinore që bie në kundërshtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Prandaj, për rastin AD.nr.10/2023 të vërtetuar me shkelje disiplinore sanksioni disiplinor **“Zvogëlim i përkohshëm i pagës tridhjetë për qind (30%) për një vit”** është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e panelit hetimor. Serioziteti i shkeljes disiplinore të kryer nga prokurorja Hava Krasniqi, pasojat e shkeljes disiplinore, rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore, sjellja e përgjithshme e subjektit të hetimit si dhe sjella dhe bashkëpunimi në procedurë disiplinore, janë rrethanat këto që kanë ndikuar në gjetjen e nivelit të proporcionalitetit në mes të shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore.

Nga sa u tha më lart, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të vlerësimit të çështjes mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.


Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial i Kosovës

T'u dërgohet:

- z. Kujtim Munishi, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë
- znj. Hava Krasniqi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë
- Arkivit të KPK-së